



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2021:050312  
Datë: 16.10.2024  
Numri i dokumentit: 06310498

C.nr.351/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtares Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen juridiko-civile, sipas padisë së paditësit M. (M.) M. nga P., të cilin e përfaqëson me autorizim av.E. G. nga Prizreni, ndaj të paditurave: Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, të cilën e përfaqësues avokatia shtetërorë N.K., dhe Drejtoria Doganore e Republikës së Kosovës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim av.B. G., me objekt kontesti, kompensim dëmi, jasht seancës më datë 16.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSIDEROHET e tërhequr, padia e paditësit M. (M.) M.. nga P., ndaj të paditurave: Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti kompenzohet demi material , në emër të mallit të konfiskuar në shumë prej 10.000€ si dhe në emër të fitimit të humbur shumen prej 3000 €.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë më datë 16.03.2021, ka paraqitur padi ndaj të paditurave: Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë dhe Drejtoria Doganore e Republikës së Kosovës në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensim dëmi material.

Gjykata lidhur me këtë çështje ka caktuar seancë me datë 26.09.2024, në të cilën kan qenë prezent : paditësi M. M., përfaqësuesi i tije av. E.G., përfaqësuesja e të paditurës Dogana e Kosoves, B. G., ku gjatë mbajtjes së seancës përgaditore pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse e pas propozimit të përfaqësuesit të paditësit, gjykata ka aprovuar propozimin e të njëjtit dhe e ka obliguar që në afat prej 15 ditësh, ta rregulloj padin me qëllim të fillit të procedurës në këtë çështje kontestimore, e në të kundërtën do të konsiderohet se paditësi ka hequr dorë padia.

Gjykata duke u bazuar në nenin 102 pika 3 e LPK-së, padinë e paditësit e konstaton të tërhequr, ku kjo dispozitë ligjore edhe shprehimisht cek se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po

që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrës do të hidhet poshtë”

Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjilan  
C.nr.351/2021, më datë 16.10.2024

Gj y q t a r ja  
Mevlide Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.